

Akt Themelimi
i Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar
"Mega Optics Distribution" sh.p.k

Neni 1

Formimi

Sot më dt. 28/02/2025 themeluesit që firmosin më poshtë:

- z. Aldi Zaçi, shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar, i lindur në Durrës, Shqipëri, më dt. 12.01.2002, dhe banues në Durrës, Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal K201120250;

Në bazë të Ligjit Nr. 9901, Dt.14.04.2008, "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregëtare" si dhe të Ligjit Nr. 9723, Dt.03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Rregjistrimit", themelojnë me vullnet të plotë dhe të lirë shoqërinë tregëtare me përgjegjësi të kufizuar, me emërtimin "Mega Optics Distribution" sh.p.k.

Neni 2

Selia e shoqërisë

Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar "Mega Optics Distribution" sh.p.k, është: Njesia Administrative Nr.7, Rruga "Muhamet Gjollesha", Hyrja 1, Nr.Pasurie 4/132-N5, Vol 19, faqe 197, ZK 8260, Tiranë, Shqipëri.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Mega Optics Distribution" sh.p.k, është pa afat nga momenti i regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Objekti i veprimtarië së shoqërisë "Mega Optics Distribution" sh.p.k është:

- 1- Tregtim me shumicë dhe pakicë si, syze optike, syze dielli, lente optike, lente kontakti, lente kozmetike
- 2- Ofrimi i shërbimit të vizitave optometrike
- 3- Eksportim, import, shitje e pajisjeve mjekësore, aksesorëve, konfeksioneve, veshjeve dhe prodhimeve industriale të ndryshme
- 4- Shoqëria për realizimin e objektit të veprimtarisë së saj, bashkëpunon dhe ndërmjeteson, me persona juridikë e fizikë që kanë të njëjtin objekt veprimtarie ose të ngjashëm me të.

Neni 5

Kapitali i shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë "Mega Optics Distribution" sh.p.k është 100,000 (Njëqind mijë) lekë dhe i përbërë nga 1 kuotë me kontributin e ortakut të vetëm si më poshtë:

○ Një kuotë për z. Aldi Zaçi, në masën 100 % (Njëqind përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë

Kapitali fillestar është i nënshkruar dhe shlyer tërësisht nga ortakët themelues, ai mund të ndryshojë sipas vendimit që mund të marrin ortakët, por asnjëherë nuk mund të pakësohet nën nivelin e kapitalit themeltar.

Neni 6

Organet e shoqërisë dhe Asambleja

Organet drejtuese të shoqërisë "Mega Optics Distribution" sh.p.k janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim-marrës
- Administrator është Z. Aldi Zaçi, shtetas shqiptar me zotësi të plotë për të vepruar, i lindur në Durrës, Shqipëri, më dt. 12.01.2002, dhe banuese në Durrë Shqipëri, mbajtës i letërnjoftimit me nr. personal K201120250. Kohëzgjatja e administratorit është për një periudhë 5 vjeçare, deri në dt. 27.02.2030.

Neni 7

Organizimi i shoqërisë

Organizimi i shoqërisë, marrëdhëniet me persona fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, shprehen në statusin e shoqërisë që së bashku me aktin themelimit janë dokumentacioni bazë i veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e marrëdhënieve në këtë shoqëri.

Neni 8

Legjislacioni

Në lidhje me veprimtarinë e saj, shoqëria do ta zhvillojë në përputhje me legjislacionin që aplikohet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 9

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të këtij akti, statuti dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japin rezultat atëherë zgjidhen me gjykatë.

Ky akt themelimi hyn në fuqi ditën e rregjistrimit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "Mega Optics Distribution" në Qendrën Kombëtare të Biznesit, dhe në këtë ditë shoqëria "Mega Optics Distribution" përfiton statusin e personit juridik.

Ortaku i vetëm i Shoqërisë

Aldi ZAÇI

